

STATUTI

I

**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"AFL" SHPK**

Neni 1

Emri

Emri i shoqerise eshte "AFL" SH.P.K.

Neni 2

Forma

Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("SH.P.K."), sipas nenit 68 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008.

Neni 3

Data e themelimit

Shoqeria eshte themeluar me date 18.01.2023.

Neni 4

Ortaket

4.1 Ortaket e Shoqerise ("Ortaket") jane:

- 1- Shoqeria "FUSHA" sh.p.k. (J61922018S), me seli ne *Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Murat Toptani, perballë Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja*, e perfaqesuar nga administratori z.Shkelqim Fusha.
- 2- Shoqeria "AGBES KONSTRUKSION" sh.p.k. (K32807432W) me seli ne *Fier Fier FIER SHEQIMADH* e perfaqesuar nga administratoret z.Arben Goga, dhe Z.Bashkim Ramaj.
- 3- Shoqeria "ALBAVIA" sh.p.k. (J81527001Q) me seli ne *Tirane Tirane TIRANE Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19* e perfaqesuar nga administratoret z.Shkëlqim Rakipaj, z.Hasan Hafizi dhe z.Vanina Latifi.
- 4- Shoqeria "KUPA" sh.p.k. (K51615512C) me seli ne *Tirane Kamez KAMEZ Rruga Berisha, Argjinaura me nr.pasurie 482, Çerkeze* e perfaqesuar nga administratori z.Qamil Kupa.
- 5- Shoqeria "ANTE-GROUP" sh.p.k. (J62904100D) me seli ne *Berat Berat BERAT Lagjia "Barrikada", Zona Kadastrale Nr.8501, Godina me Nr. Pasurie 3/423-ND* e perfaqesuar nga administratoret z. Eni Begolli, znj.Elma Doçi, z. Kristo Puleshi dhe z.Gjysho Merko.
- 6- Shoqeria "KLODIODA" sh.p.k. (K51813002H) me seli ne *Tirane Tirane TIRANE Rruga e Barrikadave, Nr.118, kati 3, Zyra Nr.2* e perfaqesuar nga administratori z.Ylli Karapici.

- 7- K32807432W Shoqeria "A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000" sh.p.k. (J62026003M) me seli ne *Tirane Vore PICAR Autostrada Tiranë-Durrës, Km 12, Picar Vorë, Ndërtesë tre kate me numër Pronësie 495978 dhe me numër Pasurie 40/57* e perfaqesuar nga administratorët z.Skender Allkja dhe z.Ledio Allkja.
- 8- Shoqeria "SPHAERA" sh.p.k. (J81809003U) me seli ne *Tirane Tirane TIRANE QAZIM VATIH 106* e perfaqesuar nga administratori z.Ajkid Topore.
- 4.2 Ortaket gcozjne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e Shoqerise te perfaqesuar ne kuota.

Neni 5
Selia

- 5.1 Selia e shoqerise ndodhet ne qytetin e Tiranës ne Republiken e Shqiperise. Adresa e sakte e selise eshte: *Rruga "Murat Toptani" nr.3-Tirane-Shqiperi.*
- 5.2 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjetër te Shqiperise. Shoqeria mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikës se Shqiperise.

Neni 6
Objekti i veprimtarise se shoqerise

- 6.1 Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne perputhje me kete Statut si dhe Kontraten e Koncesionit e cila do te nënshkruhet ndermjet Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise dhe Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive (Ortaket e Shoqerise) te shpallur fitues ne procedurën konkurruese sipas Formularit te Njoftimit te Fituesit date 14.11.2022 leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, me qellim projektimin, ndertimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Lekaj-Konjat-Fier ("**Kontrata e Koncesionit**").
- 6.2 Objekti aktivitetit te Shoqerise do te jete zbatimi i Kontrates se Koncesionit te permendur ne piken 6.1 me lart, perfshire por pa u kufizuar ne projektimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen, ne funksion te Koncesionit/partneritetit publik privat ne zbatim te parashikimeve te Kontrates Koncesionare per kete koncesion.
- 6.3 Shoqeria mund te kryeje çdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji per realizimin e objektit te aktivitetit te saj.

6.4 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut duke marre parasysh dispozitat e Kontrates se Koncesionit.

Neni 7
Kohezgjatja e shoqerise

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj dhe vepron si person juridik me personalitet te plote per te vepruar per nje kohe te pacaktuar, dhe minimalisht per nje kohe jo me te shkurter se kohezgjatja e Kontrates se Koncesionit objekt i aktivitetit te Shoqerise.

Neni 8
Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre

Personi përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e Shoqerise është z.AVNI SINAKOLI, me keto te dhena identifikimi: lindur më date 13-01-1978 në Tirane, me shtetesi Shqiptare, me nr personal H80113044F.

Kompetencat e përfaqësimit jane te plota duke i dhene tages perfaqesuesit te perfaqesojë Shoqerine ne te gjitha marrredheniet juridike dhe per te gjitha veprimet juridike ku nje nga palet e ketyre marrredhenieve juridike apo veprimeve juridike, shfaqet shoqeria "AFL" SH.P.K.

Z. AVNI SINAKOLI emerohet si administrator dhe perfaqesues i Shoqerise ne marrredhenie me te tretet, per nje afat prej 5 vitesh kalendarike, me te drejte riprteritje.

Neni 9
Specimenti i nenshkrimit (firmes) se personit qe perfaqeson shoqerine perpara te treteve

AVNI SINAKOLI
(nenshkrimi)

Neni 10
Vlera e kapitalit themeltar te nenshkruar

10.1 Kapitali themeltar i nenshkruar i Shoqerise ka nje vlere prej 100.000,00 (njqind mije) Euro.

10.2 Kapitali i Shoqerise do te shlyhet nga Ortaket, ne proporcion me pjeset e tyre takuese.

Neni 11

Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkuar

11.1 Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkuar eshte 8 (tete), në raport me kontributin e dhënë nga çdo Ortak në Shoqëri.

11.2 Çdo Ortak zotëron një kuotë të vetme në Shoqëri.

Neni 12

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkuar

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkuar eshte:

1. Nje kuote e zoteruar nga shoqeria "FUSHA" sh.p.k. (J61922018S) qe perben 42,2 % (dyzet e dy presje dy perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere 42.200,00 Euro (dyzet e dy mije e dyqind euro).
2. Nje kuote e zoteruar nga shoqeria "AGBES KONSTRUKSION" sh.p.k. (K32807432W) qe perben 21,8 % (njezet e nje presje tete perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere 21.800,00 Euro (njezet e nje mije e teteqind euro).
3. Nje kuote e zoteruar nga shoqeria "ALBAVIA" sh.p.k. (J81527001Q) qe perben 20,2 % (njezet presje dy perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere 20.200,00 Euro (njezetmije e dyqind euro).
4. Nje kuote e zoteruar nga shoqeria "KUPA" sh.p.k. (K51615512C) qe perben 10 % (dhjete perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere 10.000,00 Euro (dhjete mije euro).
5. Nje kuote e zoteruar nga shoqeria "ANTE-GROUP" sh.p.k. (J62904100D) qe perben 2,8 % (dy presje tete perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere 2.800,00 Euro (dymije e teteqind euro).
6. Nje kuote e zoteruar nga shoqeria "KLODIODA" sh.p.k. (K51813002H) qe perben 0,8 % (zero presje tete perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere 800,00 Euro (teteqind euro).
7. Nje kuote e zoteruar nga shoqeria "A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000" sh.p.k. (J62026003M) qe perben 1,7 % (nje presje shtate perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere 1.700,00 Euro (njemije e shtatqind euro).
8. Nje kuote e zoteruar nga shoqeria "SPHAERA" sh.p.k. (J81809003U) qe perben 0,5 % (zero presje pese perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, me vlere 500,00 Euro (peseqind euro).

Neni 13

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkuar

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkuar eshte:

1. Ortaku shoqeria "FUSHA" sh.p.k. (J61922018S)- 42,2 % (dyzet e dy presje dy perqind).

2. Ortaku shoqeria "AGBES KONSTRUKSION" sh.p.k. (K32807432W)- 21,8 % (njezet e nje presje tete perqind).
3. Ortaku shoqeria "ALBAVIA" sh.p.k. (J81527001Q)- 20,2 % (njezet presje dy perqind).
4. Ortaku shoqeria "KUPA" sh.p.k. (K51615512C)- 10 % (dhjete perqind).
5. Ortaku shoqeria "ANTE-GROUP" sh.p.k. (J62904100D)- 2,8 % (dy presje tete perqind).
6. Ortaku shoqeria "KLODIODA" sh.p.k. (K5181300211)- 0,8 % (zero presje tete perqind).
7. Ortaku shoqeria "A.I.T.F.A. & GEOSTUDIO 2000" sh.p.k. (J62026003M)- 1,7 % (nje presje shtate perqind).
8. Ortaku shoqeria "SPHAERA" sh.p.k. (J81809003U)- 0,5 % (zero presje pese perqind).

Neni 14

Vlera dhe lloji i kontributit te ortakeve

-Vlera e kontributit te ortakut shoqeria "FUSHA" sh.p.k. eshte 42.200,00 Euro (dyzet e dy mije e dyqind euro).

Lloji i kontributit te ortakut shoqeria "FUSHA" sh.p.k. eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

-Vlera e kontributit te ortakut shoqeria "AGBES KONSTRUKSION" sh.p.k. eshte 21.800,00 Euro (njezet e nje mije e teteqind euro).

Lloji i kontributit te ortakut shoqeria "AGBES KONSTRUKSION" sh.p.k. eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

-Vlera e kontributit te ortakut shoqeria "ALBAVIA" sh.p.k. eshte 20.200,00 Euro (njezet mije e dyqind euro).

Lloji i kontributit te ortakut shoqeria "ALBAVIA" sh.p.k. eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

-Vlera e kontributit te ortakut shoqeria "KUPA" sh.p.k. eshte 10.000,00 Euro (dhjete mije euro).

Lloji i kontributit te ortakut shoqeria "KUPA" sh.p.k. eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

-Vlera e kontributit te ortakut shoqeria "ANTE-GROUP" sh.p.k. eshte 2.800,00 Euro (dymije e teteqind euro).

Lloji i kontributit te ortakut shoqeria "ANTE-GROUP" sh.p.k. eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

-Vlera e kontributit te ortakut shoqeria "KLODIODA" sh.p.k. eshte 800,00 Euro (teteqind euro).

Lloji i kontributit te ortakut shoqeria "KLODIODA" sh.p.k. eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

-Vlera e kontributit te ortakut shoqeria "A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000" sh.p.k. eshte 1.700,00 Euro (njemije e shtateqind euro).

Lloji i kontributit te ortakut shoqeria "A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000" sh.p.k. eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

-Vlera e kontributit te ortakut shoqeria "SPHAERA" sh.p.k. eshte 500,00 Euro (peseqind euro).

Lloji i kontributit te ortakut shoqeria "SPHAERA" sh.p.k. eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 15

Kapitali fillestar i nenshkruar do te paguhet nga ortaket ne nje llogari bankare qe Shoqeria, do te hape ne nje nga Bankat e Nivelit te Dyte ne Republikën e Shqiperise, brenda nje periudhe prej 1 viti nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKB.

Neni 16

Ndalimi i konkurrences

16.1 Ndalimi i permendur ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", mund te shfuqizohet nepermjet nje autorizimi te posacem, te dhene nga ortaket e tjere sipas dispozitave te nenit 36 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

16.2 Ne mungese te nje shfuqizimi te parashikuar nga neni 16 i ketij Statuti, ndalimi i konkurrences i parashikuar ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901 dt.14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", mbetet ne fuqi deri ne 1 (nje) vit kalendarik pas humbjes se cilesive te permendura ne piken 1 te nenit 17 te ligjit nr.9901.

Neni 17


Kalimi i kuotave

17.1 Cdo transferim i kuotave apo pjeseve te tyre do te behet ne perputhje me dispozitat e Ligjit te Shoqerive, dhe te Kontrates se Koncesionit (nese aplikohet).

17.2 Fitimi apo kalimi i kuotave me kontrate, realizohet, ne cdo rast, minimalisht me akt shkresor te thjeshte dhe duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 18

Shperndarja e fitimeve



18.1 Ortaket kane te drejte te ndajne pjeset e fitimit te deklaruar ne pasqyrat financiare te Shoqerise.

18.2 Fitimi u shperndaht Ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

Neni 19
Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme e Ortakeve ("**Asambleja e Pergjithshme**"), eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per Shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- 1- Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- 2- Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- 3- Emerimin e shkarkimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- 4- Percaktimin e shperblimeve per administratoret, likujdvesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;
- 5- Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- 6- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- 7- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- 8- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- 9- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;
- 10- Nisjen e nje hetimi te posacem per parregullsite pergjate veprimve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare, hetim ky i cili kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes;
- 11- Miraton bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve, dokumente keto te paraqitura nga administratori.
- 12- Vendos per likujdimin me nje procedure te pershpejtuar sipas nenit 25 te ketij Statuti.
- 13- Ceshtje te tjera te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 19/1
Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

19/1.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

19/1.2 Asamblene e Pergjithshme, kane te drejte ta therrasin:

a- Administratoret.

b- Ortaket e pakices sipas nenit 84 te ligjit nr.9901 me nje procedure kerkese per administratorin sipas nenit 19/2 te ketji Statuti.

19/1.3 Asambleja e Pergjithshme thirret ne menyre te vecante:

a- Nese sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

b- Kur Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, pasuri te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

c- Kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje Ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton nga pasqyrat e fundit te certifikuara.

Ne rastet "a-" dhe "c-", te ketij neni, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.

Ne rastet e mesiperme (a, b, c te ketij neni), Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo duke bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

19/1.4 Ortaket do te organizojne takime me administratorin te pakten nje here ne vit me qellim vleresimin e veprimeve te kryera nga administratori, diskutimin e ceshtjeve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise dhe marrjen e vendimeve mbi ceshtjet qe jane objekt i aprovimit nga ana e tyre, perftshire ceshtje per te cilat administratori nuk bien dakord.

Neni 19/2

Menyra e thirrjes se asamblesë

19/1.1 Asambleja e Pergjithshme thirret te vendose per ceshtjet e shtruara perpara saj permes nje njoftimi me shkrese. 19/1.2 Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithë Ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblesë. Ne zarfin me te cilin dergohet njoftimi me shkrese apo cdo shkrese tjeter ne funksion te mbledhjes se Asamblese, ne anen e jashtme te pasme te tij duhet te shkruhet detyrimisht nje permbledhje e sakte e dates se hartimit te shkreses qe gjendet ne permbajtje te letres, e titullit te kesaj shkrese, dhe e permbajtjes se njoftimit me te gjitha detajet e rëndësishme qe permban letra si edhe te vuloset nga administratori i Shoqerise me vulen perkatese ose te nenshkruhet nga Ortaku i pakices qe ka thirrur mbledhjen.

19/1.3 Njoftimi me shkrese i dergohet Ortakeve, me dergese postare me lajmerim marrje (kthim konfirmimi), ne adresen e selise se tyre te deklaruar ne regjistrin tregtar qe eshte publikuar dhe administrohet nga Qendra Kombetare e Biznesit ne momentin qe kryhet njoftimi.

19/1.4 Nese Ortaku nuk do te ndodhet ne adresen e deklaruar ne statut, do te lajmeroje me shkrim administratorin e shoqerise ne lidhje me adresen e re te tij.

19/1.5 Nese Asambleja thirret nga nje administrator i cili eshte njekohesisht Ortak, atehere nuk eshte e nevojshme dergimi i njoftimit te thirrjes se mbledhjes, ortakut-administrator.

19/1.6 Nese ekziston nje vendim gjykate per pezullimin e te drejtave te ndonjerit prej Ortakeve, atehere thirren vetem Ortaket e tjere me te drejta te plota dhe vendimore. Nese nga ky vendim pezullimi, ka ngelur vetem nje ortak me te drejta ne shoqeri, dhe ky ortak eshte njekohesisht administrator, dispozitat mbi njoftimin e mbledhjes se asamblese nuk zbatohen, kur kjo mbledhje thirret nga ky administrator-ortak.

19/1.7 Ortaku i thirrur ne rast pamundesie absolute per pjesemarrjen ne mbledhje, mund ti drejtoje brenda 2 (dy) diteve nga marrja e njoftimit per thirrjen e asamblese se pergjithshme, administratorit apo ortakut te pakices (sipas nenit 84 te ligjit nr.9901), nje leter me shkrim ne adresen e deklaruar te administratorit apo ortakut te pakices qe ka thirrur mbledhjen, ku te shpjegoje arsyet e pamundesise se pjesemarrjes dhe te kerkoje shtyrjen e mbledhjes ne nje date te deshiruar nga ai jo me vone se 30 dite kalendarike nga marrja e njoftimit te pare per thirrjen e asamblese. Njekohesisht eshte i detyruar te bashkengjise prova shkresore origjinale ose te noterizuara, qe mbeshtesin arsyen e mospjesemarrjes. Ne mungese te ketyre provave kerkesa per shtyrjen e mbledhjes nuk konsiderohet dhe mospjesemarrja nuk do te pengoje mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

19/1.8 Konsiderohet marrje njoftimi per efekt te ketij Statuti, momenti qe sherbimi postar dergon letren tek marresi i njoftimit, ne adrese sipas parashikimeve te ketij statuti, pavaresisht dates se dorezimit ne sherbimin postar te njoftimit nga personi qe kryen njoftimin, dhe marresi i njoftimit e merr ne dorezim letren ose e refuzon ate.

19/1.9 Detyren dhe pergjegjesine per ti shpjeguar sherbimit postar procedurat e siperpermendura, e ka personi qe dergon njoftimin.

19/1.10 Mosrespektimi i procedurave te mesiperme te njoftimit, e ben njoftimin e pavlefshem.

19/1.11 Nese Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas rregullave te percaktuara me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë Ortaket jane prezent ne mbledhje dhe jane dakord per te marre vendime.

Neni 20/3

Procesverbali i mbledhjes mbahet gjithmone nga nje Noter i licensuar ne Republiken e Shqiperise.

Ne rastet kur prezent ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme jane te gjithë Ortaket e Shoqerise, nuk eshte e nevojshme mbajtja e procesverbalit perpara noterit, por kete procesverbal e mban administratori apo ortaku i pakices i cili ka thirrur mbledhjen.

Caktohet kryetar nenshkruer i procesverbalit administratori qe e ka thirrur mbledhjen, apo Ortaku sipas nenit 84 te ligjit nr.9901. Ne rastet kur pjesemarres ne mbledhje jane te gjithë ortaket, dhe procesverbali mbahet nga administratori apo ortaku i pakices, sipas paragrafit te mesiperm, kryetar nenshkruer caktohet ortaku me i vjeter ne moshe dhe ne rast se ky Ortak perkon me mbajtesin e procesverbalit, atehere kryetar nenshkruer caktohet ortaku tjeter me i vjeter ne moshe.

Procesverbali nenshkruhet nga kryetari dhe mbajtesi i procesverbalit.

Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarresve dhe akti i thirrjes se Asamblese.

Nese ne mbledhjen e asamblese jane te gjithë Ortaket e Shoqerise prezent nuk eshte e nevojshme ti bashkelidhet procesverbalit akti i thirrjes se Asamblese se Pergjithshme.

Vertetimi i prezences se Ortakeve ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme kryhet me ngritjen e dorës dhe vendosjen ne aktin e vecante te listes se pjesemarresve nenshkrimet te Ortakut me emer, mbiemer, dhe firme.

Neni 20/4

Nese mbledhja e Asamblese se Pergjithshme nuk respekton rigorozisht procedurat e parashikuara ne nenet 20/2 dhe 20/3 te ketij Statuti, ajo nuk mund te marre asnje vendim te vlefshem.

Neni 21

Marrja e vendimeve

Ne lidhje me vendimet per:

- 1- Ndryshimin e statutit.
- 2- Kalimin e kuotave te Shoqerise
- 3- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar.
- 4- Shperndarjen e fitimeve.
- 5- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

Edhe ne lidhje me vendimet e tjera, te renditura ne nenin 19 te ketij Statuti, Asambleja e Pergjithshme vendos me votat e ortakeve pjesemarres ne mbledhjen e asamblese, qe zoterojne te pakten 76% te kuotave te Shoqerise.

Te gjitha vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal, ne perputhje me kushtet dhe rregullat e percaktuara ne nenin 90 te ligjit nr.9901.

Neni 21/1
Kuorumi

Per vendimet qe neni 21 i ketij Statuti kerkon shumice te cilesuar prej ortakeve pjesemarres qe zoterojne 76% te kuotave ne Shoqeri, Asambleja e Pergjithshme nuk mund te marre vendime te vlefshme nese ne mbledhje nuk jane prezent personalisht ortaket qe zoterojne te pakten 76 % te kuotave dhe me te drejte vote ne Shoqeri.

Neni 21/2
E drejta e votes

Cdo kuote jep te drejten e nje vote.

Neni 22
Te drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

- 1- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- 2- Te perfaqesoje shoqerine tregtare;
- 3- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- 4- Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise dhe propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- 5- Te krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- 6- Te kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sipas ligjit "Per Qendren Kombetare te Biznesit".
- 7- Te raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

- 8- Nese jane emeruar dy ose me shume administratore, keta e administrojne bashkerisht shoqerine. Asambleja e Pergjithshme, me vendim te ortakeve qe zoterojne te pakten 76% te kuotave ne shoqeri, me vendim te vecante, mund te percaktoje qe te kete rradhe hierarkike ne administrim, nga administratore te caktuar duke specifikuar rrethanat e kesaj perparesis nndermjet administratoreve.
- 9- Ne rast likujdimi ne gjendjen e aftesise paguese, i njofton per regjistrim QKB-se te dhcnat e likujdvesve te pare dhe tagrat e tyre.
- 10- Administratorit i ndalohet te terheqe me teper se 1.000.000 (nje milion) leke, nga llogaria bankare e shoqerise per nje periudhe me te vogel se 2 muaj. Terheqjet qe administratori do te kryeje nga llogaria bankare e shoqerise detyrohet t'i dokumentoje me shkrim ne lidhje me destinacionin e tyre dhe arsyet e kesaj terheqjeje. Shkresat perkatese te realizuara me kete qellim, administratori eshte i detyruar ti ruaje dhe ti dorzoje tek ortaket ne fund te cdo muaji duke i informuar ata ne lidhje me keto terheqje, sipas dispozitave te parashikuara ne lidhje me njoftimin ne nenin 20/2 te ketij statuti. Barren e proves qe ky informim eshte realizuar e ka administratori.
- 11- Ne lidhje me veprimet ne kases fiskale te shoqerise administratori ka te drejta te pakufizuara. Veprime financiare jashte llogarise bankare te shoqerise dhe jashte kases fiskale te shoqerise, administratori i ka te ndaluara ti kryeje. Ne lidhje me shumat financiare te arketuara nga kasa fiskale e shoqerise administratori eshte i detyruar qe keto shuma ti kaloje ne llogarine bankare te shoqerise brenda 1 (nje) jave kalendarike nga data e arketimit te ketyre shumave monetare.

Neni 23

Shperblimi i administratoreve

Shperblimi i administratoreve percaktohet me vendim te zakonshem te ortakeve qe zoterojne te pakten 51% te kuotave ne shoqeri.

Shperblimi i administratorit duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare te shoqerise.

Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, asambleja e pergjithshme (me vendim te ortakeve qe zoterojne te pakten 51% te kuotave ne shoqeri,) mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratoreve ne masen e pershtatshme.

Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratoreve ne strukturen e kostove te shoqerise publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

Neni 24
Emerimi i likujduesit

Ne rast se asambleja e pergjithshme vendos per likujdimin e shoqerise ne gjendjen e aftesise paguese, ajo eshte e detyruar te caktojë likujduesin, brenda 30 diteve pas prishjes.

Ne caktimin e likujduesit duhet te kihet parasysh se ky caktim nuk duhet te paraqese arsye te mjaftueshme per te dyshuar se likujdimi i rregullt i shoqerise mund te cenohet nga likuiduesi i caktuar.

Neni 24/1
Te drejtat dhe detyrat e likujduesit

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Kufizime te caktuara per veprimtarine e likuiduesit, mund te vendosen nga ortaku i vetem ne aktin e emerimit te likuiduesit. Keto kufizime publikohen ne menyre elektronike sipas nenit 61 te ligjit nr.9723 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" dhe kane efekt edhe ndaj te treteve duke u quajtur te njohura publikisht ne perputhje me nenin 12 te ligjit nr.9901.

Likuiduesi ka detyre te ftojë kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e shoqerise.

Detyrat kryesore te likuiduesve jane:

- 1- Mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise.
- 2- Mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera.
- 3- Shitja e pasurive te shoqerise.
- 4- Shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e preferimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- 5- Kryerja e veprimeve te reja tregtare ne funksion te mbylljes se nje veprimi te paperfunduar.

Kur likuiduesit vejne re se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e pretendimeve te ngritura nga kreditorët, likuiduesi pezullon proceduren e likuidimit dhe i kerkon gjykatës nisjen e procedurave te falimentimit.

Neni 25
Shperndarja e aktiveve

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi i shperndan ortakeve aktivet e mbetura.

Neni 26

Likuidimi i thjeshtezuar

Me vendim te saj, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose per likuidimin e persheptuar.

Me marrjen e ketij vendimi dhe regjistrimin e tij te rregullt ne regjistrin e vendimeve, sipas kriterëve te ketij statuti, asambleja e pergjithshme eshte e detyruar te deklaroje perpara gjykates perkatese se te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditorëve jane shlyer e jane rregulluar te gjitha marredheniet me punemarresit.

Administratori i shoqerise njofton per regjitrin prane QKR-se vendimin e mesiperm. Administratori dhe Ortaket, jane pergjegjes solidarisht, per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likuidimit te thjeshtezuar.

Neni 27

Dispozita te fundit

Cdo ceshnje tjeter, e cila nuk eshte permendur ne kete Statut, do te rregullohet nga dispozitat e Ligjit per Shoqerite.

Nenshkrimi i Ortakeve Themelues te Shoqerise



Per shoqerine "FUSHA" sh.p.k.
Administratori


fusha

Per shoqerine "AGBES CONSTRUKSION" sh.p.k.
Administratori




Per shoqerine "ALBAVIA" sh.p.k.
Administratori

Per shoqerine "PUBLIKA UPA" sh.p.k.
Administratori




Per shoqerine "ANTE GROUP" sh.p.k.
Administratori




Per shoqerine "KLODIODA" sh.p.k.
Administratori




Per shoqerine "A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000" sh.p.k.
Administratori




Per shoqerine "SPHAERA" sh.p.k.
Administratori